V E N D I M
Nr.427, datë 11.6.2001

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË USHTARAKËVE", NË VENDIMIN NR.54, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SISTEMIN E PAGAVE TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK DHE USHTARAKËVE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË" DHE NË VENDIMIN NR.56, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË USHTARAKËVE NË SHËRBIMIN INFORMATIV KOMBËTAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.60, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës bëhet 9 720 lekë në muaj, kurse më i larti (zëvendëskomandant i Forcave Tokësore) bëhet 37 152 lekë në muaj.

b) Në pikën 2, paga e ushtarëve, nxënësve dhe studentëve ushtarakë bëhet 1 080 lekë në muaj.

c) Në pikën 5 paragrafi i tretë, paga për ushtarin rezervist bëhet 756 lekë në ditë.

ç) Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura84 240 lekë
Zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura
dhe Komandant i Forcave Tokësore75 600 lekë
Komandant i Forcave Detare dhe Komandant i Forcave Ajrore70 200 lekë
Komandant i Doktrinave dhe Komandant i Komandës Logjistike65 880 lekë
Këshilltar i Ministrit dhe drejtor drejtorie59 940 lekë

2. Në vendimin nr.54, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave "Për sistemin e pagave të Ministrisë së Rendit Publik dhe ushtarakëve të Ministrisë së Drejtësisë" bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës bazë të ushtarakut të sistemit të Ministrisë së Rendit Publik bëhet 8 338 lekë në muaj dhe niveli më i lartë (drejtor drejtorie) bëhet 36 303 lekë në muaj. Niveli më i ulët i pagës bazë të ushtarakut të sistemit të Ministrisë së Drejtësisë bëhet 7 580 lekë në muaj dhe niveli më i lartë 33 003 lekë në muaj.

b) Në pikën 3, paga e ushtarëve të shërbimit të detyrueshëm, kursantëve dhe studentëve të shkollave të Ministrisë së Rendit Publik bëhet 1 004 lekë në muaj.

c) Paga e ushtarakëve të sistemit të Ministrisë së Rendit Publik, pagë e cila është përcaktuar me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave (jashtë sistemit të pagave me klasa), rriten 8 për qind.

Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë79 780 lekë
Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Policisë72 241 lekë
Komandant i Gardës së Republikës72 241 lekë
Drejtor i Policisë së Burgjeve56 846 lekë

3. Në vendimin nr.56, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve në Shërbimin Informativ Kombëtar" bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës bëhet 7 580 lekë në muaj dhe niveli më i lartë (drejtor drejtorie) bëhet 32 076 lekë në muaj.

b) Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

Kryetar i Shërbimit Informativ98 010 lekë
Zëvendëskryetar i Shërbimit Informativ Kombëtar66 647 lekë
Inspektor i Përgjithshëm në Shërbimin Informativ Kombëtar 66 647 lekë
Drejtor i Departamentit Informativ62 204 lekë

c) Në pasqyrën e shtesave mbi pagën bazë për punonjësit e Shërbimit Informativ Kombëtar,

në pikën 2, shtesa për vështirësi vendi dhe zone bëhet “deri në 50 për qind të pagës mujore”.

4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2001 për secilin institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta